



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1961, datë 31.05.2012

Për

“Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1885, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit në zbatim të Eagle Mobile sh.a.””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 31.05.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimi i ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1885, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit në zbatim të Eagle Mobile sh.a.”

BAZA LIGJORE:

- Pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 9918);
- Neni 137, e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);

- Pika 17, e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP”, miratuar me Vendim nr. 170, datë 24.04.2004 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të Ligjit nr. 9918;
- Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar”;
- Rregullore nr. 24 datë 02.02.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me VKD Nr.1774, datë 02.02.2012”.
- Rregullore nr. 13 datë 16.04.2010 për “Portabilitetin e Numrit” (e ndryshuar), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, Datë 07.04.2010”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresën me nr. 161 Prot., datë 9.5.2012, (AKEP: nr. 919 prot, datë 10.5.2012) e sipërmarrësit Neofone sh.p.k, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 1885, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit në zbatim të Eagle Mobile sh.a.”
- Vendimit nr. 1885, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit në zbatim të Eagle Mobile sh.a.”
- Projektvendimin mbi shqyrtimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1885, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit në zbatim të Eagle Mobile sh.a.”
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Neofone sh.p.k., shpjegon se Eagle Mobile sh.a., me ndryshimet e sugjeruara dëshiron mbylljen e tregut, deformimin e tij si dhe abuzimin me FNT, disa pika të cilat amendojnë ORI-n e Eagle Mobile nuk janë të drejta dhe të bazuara në Ligjin e Republikës së Shqipërisë si dhe në praktikat Europiane;

Neofone sh.p.k., parashtrohet vërejtje dhe ndryshime si më poshtë:

- a. Në lidhje me pikën 6 në aneksin me ndryshime e miratuar, Neofone mendon se përdorimi i kapaciteteve ekskluzive për shërbimin 102 është jo në respekt të uljes së kostove për operatorët si dhe përdorimin e kapaciteteve të interkoneksionit në mënyre eficiente
Operatorët FNT gjithmonë kanë ngritur pretendime se nuk kanë kapacitete të lira për lidhjen e operatorëve të rinj si dhe për shtimin e kapaciteteve për operatorët ekzistues. Ky përcaktim do të ishte i nevojshëm nëse operatorët FNT do të vendosnin në disopozicion

një pikë tjetër interkoneksioni për shërbimin 102 të ndryshëm nga ai 101 sic edhe praktikata europiane mësojnë. Ky përcaktim do të sjellë abuzime nga operatorët FNT të cilët në asnjë rast nuk kanë deklaruar kapacitetet e lira dhe të disponueshme në respekt të kuadrit rregullator, dhe nuk do të jepnin interkoneksionin me argumentin e pavërtetë se nuk kanë kapacitete të lira;

- b. Në lidhje me pikën 7 në aneksin me ndryshimet e miratuara duhet shtuar edhe fjalët me “negociata dypalëshe sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” duke zbatuar rigorozisht vendimin e AKEP Nr. 1741 më datë 20.12.2011. Mospërcaktimi saktë ashtu sic edhe vet AKEP është shprehur do të sillte mosmarrëveshje dhe keq interpretim nga të gjitha palët;
- c. Në lidhje me pikën 8.1 ku kërkohet tabela e rrugëzimit të trafikut ndërkombëtar është e paqartë dhe krijon keqinterpretim nga ana e operatorëve FNT. AKEP duhet të shtojë se Eagle Mobile është i detyruar të jap 2 pika interkoneksioni për trafikun me origjinë ndërkombëtare duke siguruar kështu një SLA shumë të lartë për këtë trafik me gjithë se ky është diskriminim për trafikun me origjinë ndërkombëtare. Kjo pikë është e panevojshme pasi nga viti 2008 operatorët kanë punuar me një rrugëzim dhe nga OFNT nuk ka pasur ankesa për cilësimin e shërbimit me operatorët alternativë. Këtë pikë edhe vetë operatorët FNT nuk e përmbushin pasi nuk kanë 2 rrugëzime me të gjithë operatorët që kanë marrëveshje interkoneksioni. AKEP duhet të investigojë dhe duhet të kërkojë përmbushjen e këtij detyrimi edhe për trafikun kombëtar pasi ka detyrim për mbrojtjen e abonentëve shqiptar dhe arrijtjet e një niveli cilësie shumë të lartë.;
- d. Në lidhje me pikën 8.1 ku kërkohet të paraqitet ISPC si dhe një kontratë me një operator të huaj është abuzive dhe antikonkurrese. Paraqitja e kontratës me operatorin ndërkombëtar është kundra ruajtjes së konfidencialitetit është në kundërshtim me rregullat e sekretit tregtar. Duke u bazuar në nenin 18 Sekretit Tregtar të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, kjo është një kërkesë antikonkurrese pasi do të vinte Eagle Mobile në dispozicion të gjitha termat e rënë dakort ndërmjet dy operatorëve të tjerë. Po në pikën 2 të këtij Neni shprehet qartë se kur duhet të jepet një informacion i tillë palëve të tjera. Me përhapje të këtij informacioni nuk përmbushet asnjë nga parashikimet e nenit 18 pika 2 dhe është në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni. Kjo kërkesë është e pa nevojshme pasi nuk ka asnjë qëllim për mbarëvajtjen e interkoneksionit midis Eagle Mobile dhe operatorëve të tjerë;
- e. Në lidhje me pikën 8.1 ku kërkohet historiku i trafikut të dorëzuar në AKEP është e panevojshme pasi për një operator ekzistues, Eagle Mobile i ka këto statistika të cilat shkëmbehen çdo muaj me operatorët në bazë të MI. Për një operator të ri nuk mund të plotësohet pasi nuk ka deklaruar në AKEP. Është e paqartë se kur duhet të jepen këto të dhëna, dhe nuk është e qartë se cili është përfitimi i Eagle Mobile dhe operatorëve të tjerë. Nëse AKEP mendon se ky është një element shumë i rëndësishëm që i duhet mbarëvajtjes së marrëveshjes së interkoneksionit midis dy operatorëve në Republikën e Shqipërisë, në çdo moment mund t’i vendosi këto të dhëna në dispozicion OFNT-ve;
- f. Në lidhje me pikën 8.1 ku kërkohen masat e marra për aksesin në shërbimet e emergjencës, AKEP po në këtë pikë përmend se ky detyrim rrjedh nga Rregullorja për Autorizimin e Përgjithshëm. Kjo pikë lë vënd për abuzim, pasi nuk është specifikuar se kush do ta verifikojë këtë informacion të dhënë OFNT Eagle Mobile. Në të gjitha rastet OFNT-t mund të mos pranohet këto masa dhe të ngrenë pretendime, të cilat do të sjellin mosmarrëveshje.

- g. Në lidhje me pikën 8.2 ku kërkohet numri i abonentëve është përsëri abuziv dhe antikonkurrenës. Kjo kërkesë është e pa nevojshme pasi nuk ka asnjë qëllim për mbarëvajtjen e interkoneksionit midis Eagle Mobile dhe operatorëve të tjerë;

Së fundmi Neofon propozon se në aneksin me ndryshimet e miratuara të ndryshojnë ose të hiqen pikat:

- a) Pika 6 të hiqet plotësisht ose të vendoset detyrimi për lidhjen në një pikë tjetër interkoneksioni të dedikuar për trafikun ndërkombëtar.
- b) Pika 7 të ndryshohet duke vendosur: *“Tarifë Objekt negociatash komerciale sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimin elektronik në Republikën e Shqipërisë.” Eagle Mobile ka të drejtën e ndryshimit të tarifave për këtë shërbim siëas përcaktimeve të Seksion 7, Në Pjesa Kryesore të RIO”*
- c) Në pikën 8.1 ku kërkohet tabela e rrugëzimit të trafikut ndërkombëtar: Të hiqet plotësisht.
- d) Në pikën 8.1 ku kërkohet të paraqitet ISPC si dhe një kontratë me një operator të huaj: Të hiqet plotësisht.
- e) Në pikën 8.1 ku kërkohet historiku i trafikut të dorëzuar në AKEP: Të hiqet plotësisht.
- f) Në pikën 8.1 ku kërkohet masat e mara për aksesin në shërbimet e emergjencës: Të hiqet plotësisht.
- g) Në pikën 8.2 ku kërkohet numri i abonentëve: Të hiqet plotësisht.

II. AKEP për sa i përket pretendimeve të ngritura në ankimimin administrativ të sipërmarrësit Neofone sh.p.k., arsyeton si më poshtë:

- a) Në lidhje me pretendimin e Neofone për pikën 6, AKEP gjykon se administrimi i trafikut në qarqe të ndryshme E1 sipas trafikut kombëtar dhe ndërkombëtar, i shërben më mirë rritjes së cilësisë së shërbimit si dhe shmang shkaputjet e mundshme të terminimit të trafikut kombëtar në rast të problemeve me trafikun ndërkombëtar.
- b) Për pikën 7, formulimi i miratuar nga AKEP është në linjë me Vendimin nr. 1741 datë 20.12.2011.
- c) Përcaktimet e pikave 8.1 dhe 8.2 të cilat kërkohen të hiqen nga Neofone nuk përbëjnë detyrime të tepërta dhe janë në linjë me Rregulloren “Per Autorizimin e Pergjithshem” miratuar me VKD nr. 1774, date 02.02.2012, Rregulloren Per Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtar (NSPC) dhe Ndërkombëtar (ISPC) për Interkoneksionin e Rrjeteve, miratuar me Vendimin Nr.1257, datë 16. 04. 2010 te Keshillit Drejtues të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 137 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Rrëzimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k me nr. 161 Prot., datë 9.5.2012, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 1885, datë 19.04.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit në zbatim të Eagle Mobile sh.a.”*”,
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 1885, datë 19. 4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit në zbatim të Eagle Mobile sh.a.”*”,
3. Të njoftohet Neofone sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**